



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), më datë **18.06.2014** realizoi vizitë për rikontroll në **Spitalin Psikiatrik “Shkup – Bardovc** në shoqërimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm të Shoqatës së Punëtorëve Social dhe Shoqatës së Infermiereve, Teknikëve dhe Akusherëve, në bazë të nënshkrimit paraprak të Memorandumit për Bashkëpunim.

Qëllimi i vizitës për rikontroll është monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga Raporti i veçantë i MPN të vitit 2012 dhe identifikimi i rreziqeve me qëllim të parandalimit të torturës dhe llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Vizita në **Spitalin Psikiatrik “Shkup”** u zbatua në disa hapa. Ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë me drejtorinë e spitalit dhe më pas u nda në dy nënëkipe dhe bëri këqyrje në: Repartin akut, Repartin gjyqësor, Repartin për psikiatri urgjente, Repartin për trajtimin e alkoolizmit, Repartin për mjekim dhe përkujdesje të zgjatur (pavijoni për meshkuj dhe për femra), Repartin për Psikogjeriatri, Repartin për rehabilitim psikiatrik (Hostel), si dhe në Reparti për terapi okupacionale, kuzhinë, trapezari dhe depo për produkte ushqimore dhe produkte të tjera. Gjatë vizitës u zbatua edhe këqyrja e dosjeve të reparteve të vizituara, si dhe dokumentacioni për fiksime.

MPN zbatoi vizitë të targetuar, e cila u fokusua në disa konstatime negative të Raportit të veçantë të vitit 2012, si dhe bëri kontroll mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për përmirësimin e gjendjeve dhe eliminimin e mangësive dhe rreziqeve të cilat do të mund të çojnë deri në torturë ose trajtim tjetër brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues.

Gjithashtu, u vërejtën edhe gjendje të reja për të cilat nevojitet ndërmarrje e masave përkatëse të cilat, krahas rekomandimeve të vitit 2012, janë adresuar si rekomandime të reja nga vizita për rikontroll.

MPN-ja gjatë vizitës për rikontroll konstatoi se rekomandimet e Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional, të adresuara pas vizitës së realizuar në muajin nëntor 2012, pjesërisht ishin zbatuar. Vetëm disa nga rekomandimet ishin implementuar tërësisht, ndërsa disa nuk ishin implementuar fare.

Gjatë kohës së vizitës të Spitalit Psikiatrik “Shkup”, MPN-ja nuk pranoi ankesa në lidhje me sjelljen e personelit mjekësor, si dhe në lidhje me përdorimin e tepërt të forcës. Një pjesë e pacientëve u shprehën të kënaqur nga ushqimi (sa i përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit), megjithatë pati pacientë të cilët pjesërisht ishin të kënaqur nga ushqimi dhe të njëjtët cekën se kanë nevojë për shumë mish dhe perime. Në një pjesë të reparteve u vërejtën dysheqe dhe shtroje të vjetruara dhe në këtë kontekst nevojitet ndërrimi i tyre i rregullt, si dhe dezinfektimi për shkak të parandalimit të përhapjes së sëmundjeve ose bartjes së dëmtuesve të ndryshëm.

Gjatë kohës së vizitës së parë u konstatua se spitali ka në dispozicion kuadër i cili pamjaftueshëm i kënaq nevojat e këtij institucioni. MPN-ja, gjatë vizitës për rikontroll konstatoi se, ndonëse janë zbatuar punësime të caktuara, spitali ende ka mungesë të kuadrit profesional për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

MPN-ja u informua edhe për procesin rrjedhës të rinovimit dhe ndërtimit të reparteve të reja në përbërje të institucionit. Meqë vazhdojnë aktivitetet ndërtimore edhe më tej u vërejt përzierja e kategorive të pacientëve, veçanërisht në pjesën e repartit kronik.

Gjatë vizitës për rikontroll, MPN-ja konstatoi se spitali edhe më tej e përdor formën e vjetër të marrjes së pëlqimit, në të cilën qëndron se nevojitet miratim nga mjeku për dalje vullnetare të pacientit nga spitali, e që njëkohësisht është në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, i cili e përshkruan procedurën për dalje vullnetare nga institucioni shëndetësor pa paralajmërim.

MPN-ja gjatë kësaj vizite për rikontroll, nga biseda e zhvilluar me disa infermiere, u informua se në disa reparte, bërja dush bëhet në mënyrë individuale, por ka edhe një grup të pacientëve të cilët janë në gjendje më të keqe (nuk kanë mundësi që vet të bëjnë dush), të njëjtit bëjnë dush bashkë, me ndihmën e infermiereve. Në Repartin intern, ekipi i MPN-së i informua se pacientët e këtij pavijoni bëjnë dush në mënyrë individuale dhe gjithmonë në prezencë të një infermiereje.

MPN-ja gjatë vizitës për rikontroll konstatoi se ekipi i Repartit për terapi pune, për çdo ditë i organizon aktivitetet e veta në të gjitha repartet, si dhe në qendrat për shëndet mendor në bashkësi. Megjithatë, ky sektor kufizohet për shkak të nevojave për resurse të reja njerëzore, si dhe për shkak të përcaktimit të buxhetit të posaçëm për këtë segment të rëndësishëm të proceseve të tretmanëve dhe rehabilitimit të personave me sëmundje mendore. MPN-ja gjatë vizitës për rikontroll konstatoi se pacientët janë përfshirë në terapinë okupacionale, megjithatë jo në nivel të kënaqshëm dhe se ka nevojë për stimulim plotësues për përfshirjen e këtij lloji të terapisë.

Si rezultat i vizitës për rikontroll, Mekanizmi Parandalues Nacional përgatiti raport në të cilin i konstatoi gjendjet, si dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia adresoi Ministrisë së Shëndetësisë dhe IPSH Spitalit Psikiatrik "Shkup", me qëllim të eliminimit të mangësive dhe rreziqeve.